

V E N D I M
Nr.7, datë 7.1.1999

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.430, DATË
9.7.1998 "PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE, TË NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE
A INSTITUCIONEVE SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 bëhen këto ndryshime:

1.Pika 5 ndryshohet si vijon:

"Për objektet me sipërfaqe mbi 500 m², vlera e qirasë e llogaritur sipas pikës 3 dhe 4 të këtij vendimi, llogaritet me zbritje kur subjekti qiramarrës plotëson kriteret si më poshtë:

a.Kriteri i punësimit (mesatare vjetore)

- * kur punësohen 10 - 20 punëtorë 0,9 e çmimit
- * kur punësohen 21 - 50 punëtorë 0,8 e çmimit
- * kur punësohen 51-150 punëtorë 0,7 e çmimit
- * kur punësohen 151-300 punëtorë 0,6 e çmimit
- * kur punësohen 301-500 punëtorë 0,5 e çmimit
- * kur punësohen mbi 501 punëtorë 0,4 e çmimit.

b.Investimet (vjetore)

- * 300-500 mijë USD 0,9 të çmimit të fiksuar
- * 501 mijë - 1 milion USD 0,8 të çmimit të fiksuar
- * dhe mbi 1 milion USD 0,7 të çmimit të fiksuar.

Pagesa e bërë sipas kriterëve të mësipërme të jetë 3-mujore.

2.Në pikën 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kjo kontratë do të përdoret dhe për shoqëritë tregtare"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I
Pandeli Majko